



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 01.03.2025

Nr: 219

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN  
NR. 49 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË  
DEMOKRATIKE**

Sot më datë 01.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** **Z. Edi Rama**  
Kryeministër

**OBJEKT:** Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht përdorimi i punonjësve të administratës

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

**KONSTATOJ:**

Partia Demokratike më datë 21.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 49 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

*“Partia Demokratike ka marrë dijeni ndërmjet publikimeve të shumta se Kryeministri i vendit Edi Rama ka organizuar një takim me punonjësit e administratës. Sipas burimeve të ndryshme mediatike, kjo ngjarje është denoncuar edhe nga shoqatat civile. Përdorimi punonjësve të administratës shtetërore për qëllime politike përbën një veprimtari të ndaluar. ”*

Data: 01.03.2025

Nr: 219  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 49 ID, datë 21.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

Nga sa më sipër çmtoj se, ekzistojnë kushtet për t'u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:  
-Z. Edi Rama, Kryeministër.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**